

VENDIM
Nr.234, datë 19.3.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.47, DATË 22.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2020, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 1 565.

b) Në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 1, në ndarjen “Gr.13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” shtohet nëndarja sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të depozitojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	15			
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	10	Infermierë/operatore	8 orë/ditë	3 Muaj
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	5	Shoferë ambulance	8 orë/ditë	3 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	15			